



Ne Urdhrin e Mjekeve te Shqiperise me rastin e mbylljes se fushates se zgjedhjeve dhe fillimit te mandatit te ri 2015 - 2020, u zhvilluan veprimtari zgjedhore ne strukturat tona ne baze dhe ne qender.

Ato rezultuan mjaft dobiprurese. Fryti i tyre ishin jo vetem prurjet e reja ne riprertitjen e te gjitha strukturave por edhe idete, kerkesat ne rritje, mundesi dhe sugjerime te reja te dala nga analizat e bera.

Ato jane burim i madh energjie dhe potencialesh cilesore mjaft premtuese per te ardhmen e UMSH, per te realizuar veteqeverisjen dhe vetrregullimin profesional.

Vleresimi i arritjeve te deritanishme u pasua nga evidentimi i nevojave per gjallerimin dhe rritjen e punes ne te gjitha strukturat e UMSH per t'ju pergjigjur me mire te gjitha kerkesave ne rritje qe shtron koha, per te permbushur si duhet misionin dhe funksionet e UMSH.

Me mbylljen e fushates si President i ri i UMSH, une ju pershendes dhe ju falenderoj per angazhimet dhe kontributin e dhene prej secilit ne kete proces te rendesishem per te gjithe ne.

Zgjedhjen time e shoh jo vetem si nder dhe privilegj, por mbi gjithcka si pergjegjesi te madhe per te merituar dhe justifikuar besimin tuaj.

Per periudhen qe do te ushtroj detyren e nderuar te Presidentit te Urdhrit te Mjekeve une do te beje cmos per te realizuar te gjitha detyret e percaktuara ne menyre mjaft te detajuar ne Planin e Zhvillimit Strategjik 2014-2017 te Urdhrit te Mjekeve, duke u perqendruar ne rritjen e figures se mjekut, mbeshtetjen e tyre per ngritjen nga ana profesionale dhe etike, nxitjen dhe respektimin e standardeve profesionale per te rritur performancen e mjekut, cilesine e sherbimit dhe permiresimin e marredhenieve mjek-pacient, uljen e gabimeve mjekesore. Keshtu do te realizojme nje sherbim me cilesor per pacientet dhe publikun duke i mbrojtur ne raste te vecanta nga kequshtrimi i mjekesise.

Arritja e ketyre objektivave nxjerr nevojën e nje bashkepunimi te ngushte midis nesh (gjithe bashkesise se mjekeve dhe strukturave tona ne baze dhe ne qender). Vetem keshtu do te realizojme shnderrimin e Urdhrit te Mjekeve ne *SHTEPINE TONE TE PERBASHKET*.

Sigurisht forcimi i partneritetit me Ministrine e Shendetesise dhe institucionet shendetesore, universitetet dhe shoqatat mjekesore, urdhrat e tjere profesionale, si dhe gjithe faktoret dhe aktoret qe veprojne brenda sistemit shendetesor konsiderohet si kyc ne mbarevajtjen e punes dhe veprimtarise sone.

Se fundi deshiroj te falenderoj edhe mediat per punen e deritanishme dhe t'u kerkoje nje bashkepunim te frytshem ne informimin e publikut me transparence dhe vertetesi te ndodhive dhe veprimtarive tona.

PRESIDENTI

Dr. Fatmir BRAHIMAJ